



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI

Tiranë, më 24.05.2021

UDHËZIM

Nr. 4, datë 24.05.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E SHËRBIMIT USHTARAK
TË MIRATUAR ME UDHËZIMIN E MINISTRIT TË MBROJTJES NR. 13, DATË
08.10.2014 "PËR PROCEDURAT E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT
USHTARAK" DHE TË NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN E MINISTRIT TË
MBROJTJES NR. 10, DATË 27.08.2015**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", si dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

1. Në kontratën e shërbimit ushtarak, të miratuar me udhëzimin e ministrit të Mbrojtjes nr. 13, datë 08.10.2014 "Për procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak" dhe të ndryshuar me udhëzimin e ministrit të Mbrojtjes nr. 10, datë 27.08.2015, neni 3/1 ndryshon dhe bëhet:

Neni 3/1

Ndjekja e kurseve të kualifikimit/specializimit

Ushtaraku ka të drejtë që gjatë karrierës së tij të ndjekë kurse të ndryshme institucionale dhe funksionale, brenda ose jashtë vendit.

- a) Ushtaraku i FA-së që ndjek kurse institucionale ose funksionale, brenda ose jashtë vendit, përveç kurseve dhe trajnimeve të ofruara nga Zyra Amerikane e Bashkëpunimit Ushtarak

(ODC), pranë Ambasadës së SHBA-së, detyrohet të kthejë të gjitha shpenzimet e kualifikimit/specializimit, në rast se bën kërkesë për të dalë në rezervë/lirim, para plotësimit të afateve të qëndrimit në shërbim pas përfundimit të kursit, si vijon:

- Për kurse me kohëzgjatje mbi 3 muaj deri në 6 muaj, **jo më parë se 1 vit;**
- Për kurse me kohëzgjatje mbi 6 muaj deri në 1 vit, **jo më parë se 2 vjet;**
- Për kurse me kohëzgjatje mbi 1 vit deri në 3 vjet, **jo më parë se 4 vjet;**
- Për kurse me kohëzgjatje mbi 3 vjet deri në 5 vjet, **jo më parë se 6 vjet.**

b) Ushtarakët dhe personeli civil në strukturat e FA-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes, që ndjekin kurse institucionale ose funksionale, brenda ose jashtë vendit, të ofruara nga Zyra Amerikane e Bashkëpunimit Ushtarak (ODC), pranë ambasadës së SHBA-së, detyrohen të kthejnë të gjitha shpenzimet e kualifikimit/specializimit, në rast se bëjnë kërkesë për të dalë në rezervë/lirim, para plotësimit të afateve të qëndrimit në shërbim pas përfundimit të kursit, si vijon:

- Për kurse të nivelit të lartë që njësohen me kurse të nivelit L7, K5, K6 dhe K7 në sistemin arsimor të FA-së, si dhe për studime pasuniversitare, **jo më parë se 3 vjet;**
- Për kurse institucionale dhe funksionale të nivelit të ulët, kurset e instruktorit, si dhe kurse të tjera, **jo më parë se 2 vjet.**

c) Me ushtarakët që do të ndjekin kurse të ofruara nga ODC, nënshkruhet kontrata sipas modelit A1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij udhëzimi.

d) Me civilët që do të ndjekin kurse të ofruara nga ODC, nënshkruhet kontrata sipas modelit A2, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij udhëzimi.

2. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi: Forca Tokësore, Forca Detare, Forca Ajrore, Komanda Mbështetëse, Akademia e Forcave të Armatosura, repartet e varësisë së drejtpërdrejtë, Qendra e Personel-Rekrutimit, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin i Përgjithshëm të FA-së.

3. Ndjekin zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

, **MINISTRI**

Niko Peleshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

KONTRATË

**PËR NDJEKJEN E KURSEVE INSTITUCIONALE DHE FUNKSIONALE TË
OFRUARA NGA ZYRA AMERIKANE E BASHKËPUNIMIT USHTARAK (ODC) NGA
PERSONELI USHTARAK I FORCAVE TË ARMATOSURA**

Bazuar në ligjin nr. 59/2014, datë 12.06.2014 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në shkronjën “c”, të kreut V, të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 13, datë 08.10.2014 “Për procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak”, të ndryshuar:

Sot më datë _____. _____. _____, në Ministrinë e Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës, Tiranë,
Tel: ++355 4 2226601; Faks: ++35542228325,

Lidhet kjo kontratë midis palëve:

Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësuar nga _____, me detyrë
(Grada Emri Mbiemri)

Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe
_____, me nr. ID _____, për ndjekjen e
(Grada Emri Mbiemri)
studimeve në _____.

Institucioni arsimor: _____, SHBA
(Emërtimi i institucionit arsimor/shkollës/institutit/kolegjit/universitetit)

Kursi: _____
(Emërtimi i kursit)

për periudhën _____. _____. _____ deri më _____. _____. _____, miratuar me urdhër të ministrit të
Mbrojtjes nr. _____. _____. _____.

Palët kontraktuese bien dakord, për sa më poshtë:

KREU I

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Mbrojtjes

1. Duke bashkëpunuar me shtetin pritës, krijon të gjitha kushtet e nevojshme për ndjekjen e trajnimit/kualifikimit.
2. Mbulimi i shpenzimeve për trajnimin/kualifikimin, akomodimin, ushqimin, udhëtimet, siguracionin shëndetësor, do të bëhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me shtetin pritës.
3. Ministria e Mbrojtjes, gjatë periudhës së studimeve, garanton trajtimin financiar të studentit/kursantit civil, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjes së lidhur me shtetin pritës.
4. Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet atashut ushtarak të Republikës së Shqipërisë në SHBA, merr informacionin e nevojshëm mbi mbarëvajtjen e trajnimit/kualifikimit dhe sjelljes së ushtarakut.
5. Në përfundim të kualifikimit, ushtaraku kthehet në detyrën që ka pasur ose emërohet në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel ose në një nivel më të lartë, në përputhje me kualifikimin e kryer. Në qoftë se ushtaraku nuk ka qenë i emëruar në detyrë para fillimit të studimeve, ai emërohet në përputhje me kualifikimin e kryer.
6. Ministria e Mbrojtjes njeh paraprakisht studentin me marrëveshjen përkatëse mes dy qeverive, si dhe me detyrimet kontraktuale dhe rregullat që ushtaraku duhet të zbatojë në shtetin pritës gjatë periudhës së ndjekjes së kursit.

KREU II

Të drejtat dhe detyrimet e ushtarakut

1. Ushtaraku duhet të zbatojë ligjet e shtetit pritës, të ndjekë rregullisht studimet (kualifikimin) dhe të zbatojë rregullat e shkollës/akademisë ku ndjek studimet.
2. Në rast se ushtaraku nuk arrin të përfundojë studimet (kualifikimin) me sukses, për shkaqe subjektive, i nënshtrohet penaliteteve të parashikuara në Kreun III të kësaj kontrate.
3. Pas përfundimit të studimeve (kualifikimit), ushtaraku brenda 30 ditëve duhet të paraqitet personalisht, së bashku me dokumentacionin e plotë mbi përfundimin e studimeve, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Mbrojtjes.
4. Pas përfundimit të kualifikimit, ushtaraku është i detyruar të punojë në strukturat e Forcave të Armatosura, për të paktën për një periudhë prej ____ vite, në përputhje me detyrimin e parashikuar në nenin 3/1, të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 13, datë 08.10.2014 "Për procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak", i ndryshuar.
5. Ushtaraku, në raste të shkeljes së ligjeve të shtetit pritës, mban përgjegjësi individuale, sipas legjislacionit të shtetit përkatës.

6. Ushtaraku, gjatë kohës së studimit (kualifikimit), rezervon të drejtën e kërkesës për ndërprerjen e studimeve (kualifikimit), për raste objektive. Kjo kërkesë duhet të miratohet nga ministri i Mbrojtjes.

KREU III

Penalitetet

1. Në rast moskthimi në atdhe të ushtarakut, pas përfundimit/ndërprerjes të studimeve, për shkaqe subjektive, ai kallëzohet nga organet përkatëse, për ndjekje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Në rast se ushtaraku, pas kualifikimit, nuk pranon të shërbejë në strukturat e Forcave të Armatosura, sipas pikës 5, të Kreut I, pikës 4, të Kreut II apo nuk arrin të përfundojë studimet, sipas pikës 2, të Kreut II të kësaj kontrate, ai detyrohet të dëmshpërblejë shpenzimet e kryera për kohën e studimit, sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes, i cili në këto raste përbën "titull ekzekutiv" dhe për zbatimin e tij ngarkohen organet përmbarimore.
3. Shpenzimet përcaktohen nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me shtetin pritës, Drejtorinë e Politikave NATO dhe BE, Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtorinë e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm dhe Akademinë e Forcave të Armatosura.

KREU IV

Dispozita të fundit

1. Mosmarrëveshjet që lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate, palët i zgjidhin me mirëkuptim, në rast të kundërt palët i drejtohen instancave gjyqësore kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore e gjykimit, sipas përcaktimeve të dispozitave procedurale në fuqi.
2. Për problemet që mund të lindin gjatë periudhës së studimeve, Ministria e Mbrojtjes kontakton me familjen e studentit civil, në adresën:

(Emri Mbiemri i personit pikë kontakti)

(lidhja familjare)

(adresa)

(numër telefoni)

ndërsa personi kontakton me Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në nr. tel: ++355 222 6601. Çdo ndryshim adrese ose numër kontakti nga njëra palë i njoftohet me shkrim palës tjetër dhe konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3. Kjo kontratë, pasi u lexua dhe u kuptua, nënshkruhet me vullnetin e lirë e të plotë të palëve, dhe hyn në fuqi në momentin e fillimit të studimeve (kualifikimit) të ushtarakut.
4. Kontrata përpilohet në 3 (tri) kopje me nga 3 (tri) fletë secila, (një kopje qëndron në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, një vendoset në dosjen personale të ushtarakut dhe tjetra i jepet personit që shkon me studime ose kualifikime).

PALËT NËNSHKRUESE

PERSONI QË KUALIFIKOHET

Emri Mbiemri

**PËRFAQËSUESI I MINISTRISË SË MBROJTJES
DREJTORI I DMBNJSH**

Grada Emri Mbiemri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

KONTRATË

**PËR NDJEKJEN E KURSEVE INSTITUCIONALE DHE FUNKSIONALE TË OFRUARA NGA
ZYRA AMERIKANE E BASHKËPUNIMIT USHTARAK (ODC) NGA PERSONELI CIVIL I
FORCAVE TË ARMATOSURA**

Bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në Kreun IV dhe V të VKM nr.138, datë 12.03.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimit të nëpunësve civil”, e ndryshuar, në germën b, të pikës 10, të Kreut I, të VKM nr.124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” e ndryshuar, në ligjin 7961, datë 12.07.1995 ‘Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “c”, të kreut V, të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 13, datë 08.10.2014 “Për procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak”, të ndryshuar:

Sot më datë _____, në Ministrinë e Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës, Tiranë, Tel: ++355 4 2226601; Faks: ++35542228325,

Lidhet kjo kontratë midis palëve:

Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësuar nga _____, me detyrë
(Grada Emri Mbiemri)

Drejtor i Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe
Z/Znj. _____, me nr. ID _____, për ndjekjen
(Emri Mbiemri)
studimeve në _____, SHBA.

Istitucioni arsimor: _____
(Emërtimi i institucionit arsimor/shkollës/institutit/kolegjit/universitetit)

Kursi: _____
(Emërtimi i kursit)

për periudhën _____ deri më _____, miratuar me urdhër të ministrit të
Mbrojtjes nr. _____.

Palët kontraktuese bien dakord, për sa më poshtë:

KREU I

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Mbrojtjes

1. Duke bashkëpunuar me shtetin pritës, Ministria e Mbrojtjes krijon të gjitha kushtet e nevojshme për ndjekjen e kursit.
2. Mbulimi i shpenzimeve për trajnimin/kualifikimin, akomodimin, ushqimin, udhëtimet, siguracionin shëndetësor, do të bëhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me shtetin pritës.
3. Trajtimi financiar dhe marrëdhëniet e punës gjatë kryerjes së trajnimit jashtë vendit, rregullohen në bazë të legjislacionit në fuqi.
4. Për kurse me kohëzgjatje nga 1 (një) muaj deri në 2 (dy) vjet të ndërmarra me nismën e vetë nëpunësit, në pikës 7, të Kreut IV, të VKM nr. 138, datë 12.03.2014, e ndryshuar, nëpunësi pezullohet nga shërbimi civil.
5. Kur nëpunësi ndjek kurse me kohëzgjatje deri në 3 muaj, me kërkesën e institucionit/strukturës përkatëse, në bazë të VKM nr.138, datë 12.03.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civil", e ndryshuar, nëpunësit i ruhet vendi i punës dhe trajtohet me pagën e plotë, përveç shtesës për vështirësi e kushte pune. Kur kurset janë me kohëzgjatje mbi 3 muaj nëpunësi pezullohet nga shërbimi civil. Në këtë rast Ministria e Mbrojtjes bashkëpunon me DAP-in për punësimin e nëpunësit në strukturat e FA-së, në të njëjtin pozicion pune që nëpunësi kishte para fillimit të studimeve ose në një pozicion tjetër, në përputhje me trajnimin e kryer.

KREU II

Të drejtat dhe detyrimet e studentit

1. Studenti duhet të zbatojë ligjet e shtetit pritës, të ndjekë rregullisht studimet, dhe të zbatojë rregullat e shkollës/akademisë ku ndjek studimet. Në raste të shkeljes së ligjeve të shtetit pritës, studenti mban përgjegjësi individuale.
2. Pas përfundimit të studimeve, studentit brenda 30 ditëve duhet të paraqitet personalisht, së bashku me dokumentacionin e plotë mbi përfundimin e studimeve, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Mbrojtjes.
3. Pas përfundimit të studimeve, studentit është i detyruar të punojë në strukturat e Forcave të Armatosura, për të paktën për një periudhë prej ____ vite, në përputhje me detyrimin e parashikuar në pikën 4, të Kreut IV, të VKM Nr.138, datë 12.03.2014, e ndryshuar dhe në nenin 3/1, të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 13, datë 08.10.2014, të ndryshuar.

KREU III

Penalitetet

1. Në rast se studenti, pas kualifikimit, refuzon të të punojë në ministrinë e Mbrojtjes, strukturat e Forcave të Armatosura dhe strukturat e varësisë së tyre, në bazë të pikës 5, të Kreut V, të VKM nr. 138, datë 12.03.2014, e ndryshuar, ai detyrohet të dëmshpërblejë institucionin për shpenzimet e kryera për trajnimin e tij.
2. Shpenzimet në ngarkim të studentit përcaktohen nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me shtetin pritës, Drejtorinë e Politikave NATO dhe BE, Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtorinë e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm dhe Akademinë e Forcave të Armatosura.

KREU IV

Dispozita të fundit

1. Mosmarrëveshjet që lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate, palët i zgjidhin me mirëkuptim, në rast të kundërt palët i drejtohen instancave gjyqësore kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore e gjykimit, sipas përcaktimeve të dispozitave procedurale në fuqi.
2. Për problemet që mund të lindin gjatë periudhës së studimeve, Ministria e Mbrojtjes, kontakton me familjen e studentit, në adresën:

(Emri Mbiemri i personit pikë kontakti)

(lidhja familjare)

(adresa)

(numër telefoni)

ndërsa personi kontakton me Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në nr. tel: ++355 222 6601. Çdo ndryshim adrese ose numër kontakti nga njëra palë i njoftohet me shkrim palës tjetër dhe konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3. Kjo kontratë, pasi u lexua dhe u kuptua, nënshkruhet me vullnetin e lirë e të plotë të palëve, dhe hyn në fuqi në momentin e fillimit të studimeve (kualifikimit) të studentit civil.
4. Kontrata përpilohet në 3 (tri) kopje me nga 3 (tri) fletë secila, (një kopje qëndron në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, një vendoset në dosjen personale të civilit dhe tjetra i jepet personit që shkon me studime ose kualifikime).

PALËT NËNSHKRUESE

PERSONI QË KUALIFIKOHET

**PËRFAQËSUESI I MINISTRISË SË MBROJTJES
DREJTORI I DMBNJSH**

Emri Mbiemri

Grada Emri Mbiemri